

Vend i lirë pune:

## ASISTENT FINANCIAR

Würth-Kosova Shpk është pjesë e koncernit botëror WÜRTH-GROUP dhe njëra nga kompanitë lidere në Republikën e Kosovës. Merremi me shitjen dhe distribuimin e produkteve për auto/cargo, metal, industri të drurit dhe ndërtimit (montim dhe elemente lidhëse për prodhim industrial, vegla të ndryshme dore, vegla elektrike, motorike ose me bateri, pajisje mbrojtëse, bulona, materiale shpenzuese për industrinë automobilistike, elemente lidhëse për mobilieri dhe karpentieri, produkte teknike-kimike etj).

Pas procesit orientues dhe trajnimit të vazhdueshëm, ju do të mirëmbani sistemin e informacionit të raportimit financiar, harmonizimet bankare, të bashkëpunoni me departamentet tjera, dhe do të raportoni te udhëheqësi i financave mbi raportimet mujore.

### Kriteret dhe kualifikimet e nevojshme:

Diplomë universitare në ekonomi, finance ose të ngjashme, njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze, njohuri të pakos softuerike MS Office, leje drejtimi autoveture, interesim dhe përvojë në kryerjen e detyrave numerike, shkathtësi dhe dëshirë për përvetësim dhe avancim të njohurive të reja.

Kandidati-ja preferohet të ketë:

- Bachelor ne kontabilitet ose fushë të ngjashme
- Kualifikimet nga SCAAK - teknik i kontabilitetit
- Aftësi në menaxhimin e kohës dhe prioriteteve

Nëse dëshironi punë në një ambient dinamik, në skuadër ku promovohen vlerat, suksesi dhe qasja e shërbimit ndaj klientit atëherë ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në: [info@wurth-kosova.com](mailto:info@wurth-kosova.com)



Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga skuadra jonë e vlerësimit do të ftohen për intervistë. Afati i aplikimit deri: **22 maj 2022.**